

## Komuna e Prishtinës/Priština

### Hafir (Isuf) Shala

(15.02.1960, shqiptar nga Glllogoci/Glogovac, mjek, gjashtë fëmijë)

Hafiri punonte në Shtëpinë e Shëndetit në Glllogoc/Glogovac. Ishte anëtar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dhe ka qenë i angazhuar në grumbullimin e ndihmave humanitare. Shpeshherë u ofronte ndihmë ushtarëve të plagosur të UÇK-së. Në datën **10.04.1998**, ishte nisur me Hetem Sinanin dhe Shaban Nezirin për në Prishtinë/Priština. Rreth orës 8:00, veturën me të cilën udhëtonin e kishte ndaluar policia e komunikacionit, në fshatin Sllatinë/Slatina. Në afërsi ishte i parkuar një xhip me ngjyrë të zezë, me targa të Prishtinës. Derisa policia i kontrollonte dokumentet e tyre personale, tre burra në rroba civile Hafirin e futën në xhip, ndërsa i katërti i futi Hetemin dhe Shabanin në automjetin e policisë. Ata i dërguan në stacionin policor në **Prishtinë/Priština**, ku janë marr në pyetje në dhoma të ndara. Po atë ditë, Hetemi dhe Shabani ishin liruar, ndërsa Hafiri u ndalua. Duke u larguar nga stacioni, ata kishin dëgjuar britmat e Hafirit. Familja e Hafirit, AI, HRW dhe FDH i kishin drejtuar institucioneve të Republikës së Serbisë, lidhur me zbardhjen e fatit të tij. Prokurori Publik i Qarkut në Prishtinë/Priština ishte përgjigjur se ata nuk kishin të dhëna se ku gjendej Hafiri. Për fatin e Hafirit deri më sot nuk dihet asgjë. Në regjistrin e të zhdukurve të KNKK-së, rasti i tij është i evidentuar me numër YUK-000100-01.

**Burimet:** deklarata S.H, FDH-36774; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795; KMDLNJ,

*Buletini*, num. 7, prill - qershor 1998, 143, FDH -23816; HRW, *Shkeljet...*, 60-61, FDH-31132; ICTY, IT-03-66 (F. Limaj dhe të tjerë), transkript, 10.02.2005, 22, FDH-31425; *Medicial action: Disappeared doctor – Dr Hafir Shala*, pasqyra e lajmeve, AI, 01.05.1998, <http://asiapacific.amnesty.org/library/Index/ENGEUR700-231998?open&of=ENG-2AS>; *Pod Lupom: Kosovo-ljudska prava u vreme oružanih sukoba*, Buletini numër 26, FDH, Beograd, maj 1998, FDH-20114; *Nestanci na Kosovu, januar-maj 1998*, pasqyra e lajmeve, Naša borba, jun 1998, [http://www.yurope.com/nasa-borba/arhiva/Jun98/0706/0706\\_3.HTM](http://www.yurope.com/nasa-borba/arhiva/Jun98/0706/0706_3.HTM).

### Isuf (Salih) Hajdari

(19.05.1940, shqiptar nga Prishtina/Priština, punëtor, pesë fëmijë)

### Agron (Muharrem) Rrahmani

(20.04.1971, shqiptar nga Prishtina/Priština, student, një fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Në vitin 1989, Agroni ishte pjesëmarrës i demonstratave në Podujevë/Podujevo kundër pushtetit serb, për çka ishte i dënuar me dy muaj burgim. Në vitin 1992, bëhet anëtar i Lëvizjes Kombëtare për Çlirimin e Kosovës. Gjithashtu, ishte edhe komandant i Njësisë së UÇK-së, *Rexhep Mala*. Ai kishte studiuar në Prishtinë/Priština dhe banonte me disa studentë në banesë, që e mori me qira nga Isuf Hajdari. Në natën në mes 11 dhe **12.05.1998**, rreth orës 2:30, në afërsi të banesës së dhënë me qira dhe shtëpisë së Isuf Hajdarit [*Lagja e Muhaxhirëve/Naselje Muhadžeri*] në **Prishtinë/Priština**, Agroni është plagosur gjatë konfliktit me policinë serbe. Fatmir Humolli, i cili gjithashtu ishte i plagosur, e kishte nxjerrë dhe fshehur në shtëpi të vet,